



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT



DREJTORATI I INSPEKSIONIT

Datë :	03.04.2025
Referencë	11-344/3
Për :	Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës
Kopje:	Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës
Kopje:	Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës
Nga:	Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit
Lënda :	Raporti i muajit-mars

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit mars Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektorët e tregut- gjatë këtij muaji kanë inspektuar biznese të ndryshme afariste, objektivi i inspektimit ka qenë regjistrimi i bizneseve, pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet biznes, janë dhënë urdhëresa për pranim teknikë, si dhe në bazë të kërkesave nga bizneset janë bërë pranime teknike të lokaleve afariste. Gjithsejtë janë realizuar 20 pranime teknike të lokaleve afariste.

Në fokus ka qenë inspektimi i marketeve. Janë kontrolluar për çmimin e artikujve, përputhshmërinë e çmimeve raft-arkë si dhe vendosjen e flamujve të cilët tregojnë origjinën e mallit.

Janë inspektuar furrat e bukës, në lidhje me çmimet e ekspozuara, peshat e deklaruara për artikujt e ekspozuar, kalibrimin e peshoreve etj,

Në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë inspektuar rentat që ushtronin veprimtari ilegale brenda hapësirave të Aeroportit.

Gjatë muajit shkurt është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në fshatrat Shalë, Gadime pastaj në kodrën e Kërçevës, për të marrë masa ligjore ndajë ndotësve të cilët takohen apo gjeten dëshmi për ndotjen e bërë.

Janë inspektuar operator për tu pajisur me leje mjedisore komunale, si dhe zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale për ata operator të cilët tani më janë të pajisur me këtë dokument. Janë inspektuar operator me aktivitet auto-servis, operator për prodhim të dyerve dhe dritareve nga plastika, të cilët janë urdhëruar që të pajisen brenda një kohe të caktuar me leje mjedisore komunale si dhe zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale tek objekte të larta ndërtimore në ndërtim e sipër. Janë dhënë urdhëresa për grumbullim të mbeturinave në vend punishte dhe mos të shkaktohet pluhur gjatë kryerjes së punimeve.

Është bërë inspektim së bashku me policin në fshatin Shalë dhe Janjevë. Në fshatin Shalë ankesa ishte për gropim të kodrës pronë e agjencionit të pyjeve. Gjatë kontrollës nuk ishte askush duke punuar. Në Janjevë ankesa ishte nga komuniteti Kroat për prezencën e lagështisë në shtëpinë e tyre gjeja si pasoj e rrjedhjeve të ujit nga ujësjellësi.

Është bërë rikontrolle tek një autolarja për urdhëresën e dhënë për të bërë kontratë për mbeturina, urdhëresa ishte zbatuar nga biznesi.

Gjatë kontrollës në pjesën e ish Fabrikës së letrës ku janë duk u ndërtuar objektet banesore është vërejt ndotje e mjedisit me material mazut, i derdhur në hapësirën ku kanë qen rezervarët. Ndotja është bërë si pasoj e largimit të rezervarëve pa ndonjë planë. Për ndotjen që është bërë, e që paraqiste rrezik për ndotjen ujërave sipërfaqësor por edhe të bunarëve që furnizohet me ujë të pijes

qyteti dhe disa fshatra, menjëherë është lajmëruar përmes emailit rasti tek inspektorët e Ministrisë, ku edhe kemi bërë inspektim bashkarishtë. Për ndotjen e bërë janë lajmëruar Ujësjellësi, Policia njësinë për Krime Mjedisore dhe organet tjera, ku edhe janë duke u marrë me problemin. Inspektorët e Ministrisë i kanë dhënë urdhëresë operatorit i cili ka operuar dhe pronarit të tokës që menjëherë të menagjohen këto mbetje, të vendosen në rezervarë deri në urdhëresat e ardhshme për eliminimin e tyre. Jemi duke e bërë monitorimin e largimit mbetjeve sipas urdhësive të inspektorëve të MMPHI.

Inspektorët e trafikut- objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal.

Janë bërë inspektime në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksi të cilët merrnin pasagjer pa porosi që është në kundërshtim me Ligjin. Është shqiptuar një gjobë dhe janë përjashtuar nga komunikacioni duk ju konfiskuar targat dhe librezat e mjetit, për firmat e radio- taksi të cilët merrnin pasagjer pa porosi telefonike kemi marrur masa ligjore sipas ligjit dhe rregullores për taksi.

Janë inspektuar disa kompani për bartjen e nxënësve në shkollë ku janë dhënë vërejtje për ta respektuar kontratën që kanë me Komunën për bartjen e nxënësve.

Në fshatin Slllovi janë inspektuar rrugët ku kompania e ujësjellësit KUR- Prishtina ka intervenuar në rrugën “Agron Gashi” të lagjia e Hashanve, pa pëlqim për prerjen e asfaltit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim. Për shkeljet ligjore që janë bërë kompanisë së lartë cekur i është shqiptuar fletëparaqitje në Gjykatë.

Inspektori i ndërtimit- ka realizuar inspektime të vazhdueshme në tren përgjatë zonave urbanistike. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore. Ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve si dhe është bërë vendosja e shiritave zyrtar.

Drejtorja e Inspektoratit është përgjegjshme në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit mars janë:

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste si dhe janë bërë pesë pranime teknike te lokaleve afariste.

Ndalimi i shitjes jashtë tregut.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Vërejtje, njoftime	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoha mandatore	Te hyra nga pranime teknike	Inspektim i bizneseve pa pranime teknike	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektim i bizneseve pa regjistrim
Biznesi	139	26	20	1					50	9					1	12	20			
Ambienti	38	10						3	8	6			1					7	3	
Ndërtimi	58	16			18		2		2	18							2			
Trafiku	97	22						27		17		12	1			8	5		5	
Gjithsej	332	74	20	1	18		2	30	60	50		12	2		1	20	27	7	8	

DISKUTIMET PUBLIKE

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

TAKIME TË TJERA

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

SFIDAT

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Inspektimi i bizneseve të paregjistruara, pa pranime teknike.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.